



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2022:237510
Datë: 12.04.2024
Numri i dokumentit: 05566866

AC-I-23-0268

Në ankesën e

Paditësi/Ankuesi

B K, Prishtinë, i përfaqësuar nga avokati **B I**, nga Prishtina.

kundër

E paditura

NSH "Magjistranja" Prishtinë (në likuidim), përfaqësuar nga, **Agjencia Kosovare e Privatizimit**, Rr. "Dritan Hoxha" nr.55, Lakrishtë, Prishtinë.

Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DHPGJS), i përbërë nga Mr.sc. Sahit Sylejmani, gjyqtar kryesues, Ilmi Bajrami dhe, Diellza Hoxha gjyqtar, duke vendosur lidhur me ankesën e paditësit, të parashtruar kundër Aktgjykimit të Shkallës së I-rë të DHPGJS-së, C-IV-13-1022, të datës 24 prill 2023, pas seancës vendimmarrëse të mbajtur me 12 prill 2024, lëshon këtë:

A K T G J Y K I M

- 1. Ankesa e paditësit është e bazuar.**
- 2. Ndryshohet Aktgjykimi i Shkallës së I-rë të DHPGJS-së, C-IV-13-1022, i datës 24 prill 2023.**
- 3. Obligohet AKP-ja – Autoriteti i Likuidimit që ti paguajë paditësit në emër të pagave të pa paguara për periudhën janar 2006 – prill 2007, shumën prej 5,406.08 euro, si dhe shpenzimet e përfaqësimit nga ana e avokatit në shumë prej 208 euro, të cilat shuma do të paguhen sipas prioriteteve të përcaktuara me ligj në procedurën e likuidimit.**

4. Nuk caktohen taksa gjyqësore për procedurën ankimore.

Rrethanat faktike dhe procedurale:

Me datë 25 qershor 2013, paditësi e dorëzoi në DHPGJS një ankesë kundër vendimit të Autoritetit të Likuidimit PRN032-0237, të datës 31 maj 2013, me të cilën kërkesa e paditësit për kompensim të pagave të pa paguara, për periudhën janar 2006 – prill 2007, në shumë prej 5,406.08 euro, refuzohet si e pa vlefshme me arsyetimin se paditësi nuk ka kryer asnjë shërbim pune dhe nuk ka qenë në listën e pagave për ndërmarrjen për periudhën e cekur. Kjo ankesë ishte u regjistruar me numrin C-IV-13-1022. Paditësi në ankesë pohon se Autoriteti i Likuidimit nuk e ka vërtetuar drejtë gjendjen faktike pasi që ai pohon se e kishte pranuar letër pezullimin nga AKM-ja, me të cilën dëshmohet se ai ka punuar deri me 22 maj 2007. Tutje paditësi pohon se NSH-ja e paditur ishte obliguar ti paguaj pagat për periudhën e cekur. Paditësi në ankesë ka kërkuar që të aprovohet ankesa dhe atij ti njihet e drejta e kompensimit të pagave të papaguara. Me këtë ankesë paditësi ka kërkuar edhe shpenzimet e përfaqësimit. Me ankesë paditësi ka dorëzuar Autorizimin e Avokatit, kopjen e Letërnjoftimit dhe Vendimin e ankimuar të Autoritetit të Likuidimit, formularin e kërkesës të dorëzuar tek Autoriteti i Likuidimit, një kopje të AKP-së për dokumentacion shtesë, dhe një regjistër të pagave të pa paguara.

Me datë 20 nëntor 2013, AKP-ja e dorëzoi në DHPGJS mbrojtjen në ankesë. Në mbrojtjen në ankesë AKP-ja pretendon se Autoriteti i Likuidimit ka kryer një vlerësim të saktë të rrethanave faktike dhe ka zbatuar drejtë dispozitat materiale. AKP-ja pohon se ankesa është e pa pranueshme pasi që është paraqitë pas afatit, dhe është pa asnjë verë ligjore. Tutje pohon se parashtresa për rregullim dhe plotësim të padisë për veq që është e pa pranueshme, ajo nuk bazohet në gjendjen faktike të vërtetuar nga Autoriteti i Likuidimit. AKP-ja pohon se Autoriteti i Likuidimit ka kompetencë të vlerësoj se paga është një e drejtë që buron nga marrëdhënia e punës për punën e kryer, ndërsa paditësi nuk mund të vlerësohet se ka kryer ndonjë punë për NSH në periudhën e cekur, andaj nuk mund të pretendon paga ndaj NSH-së. Tutje AKP-ja pohon se lista e 20% nuk ka asnjë ndikim lidhur me kompensimin e pagave të pa paguara. AKP-ja në mbrojtje në ankesë ka kërkuar që të refuzohet ankesa si e pa bazuar dhe të vërtetohet vendimi i ankimuar i Autoritetit të Likuidimit.

Me datë 15 shkurt 2023, Shkalla e I-rë e DHPGJS-së e lëshon një Urdhër për paditësin me të cilën kërkohet që ai ta dorëzojë në Gjykatë Njoftimin për ndërprerjen e marrëdhënies së punës me datë 22 maj 2007, të cilit i është referuar në ankesë si dhe Librezën e punës në kopje. Ky urdhër është pranuar nga avokati i paditësit E M me 21 shkurt 2023.

Me datë 23 shkurt 2023, avokati i paditësit E M e dorëzon një parashtresë në DHPGJS, në të cilën ai sqaron se paditësi e ka tërheq autorizimin e dhënë ndaj tij dhe se komunikimi i gjykatës duhet të bëhet drejtpërdrejtë me palën.

Me datë 24 prill 2023, Shkalla e I-rë e DHPGJS-së me Aktgjykimin C-IV-13-1022, ankesën e paditësit e refuzon si të pa bazuar, dhe e vërteton vendimin e ankimuar të Autoritetit të Likuidimit si të drejtë dhe të bazuar në ligj. Shkalla e -rë e DHPGJS-së ka arsyetuar se në bazë të nenit 7 të LPK-së palët kanë për detyrë ti paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatojnë faktet e tilla. Në këtë rast ishte përgjegjësi e palës paditëse ti vërtetojë pretendimet e veta për pagat e pretenduara ndaj NSH-së, respektivisht të provojë se kur ka themeluar marrëdhënie punë dhe kur e ka përfunduar punën në NSH. Tutje Shkalla e I-rë konstaton se në mungesë të provave të mjaftuara nuk janë përmbushur kushtet ligjore për të nxjerrë një vendim meritore lidhur me ankesën, ndërsa mbajtja e një seance dëgjimore në këtë rast është e panevojshme. Andaj nga këto arsye në mungesë të provave materiale është refuzuar ankesa si e pa bazuar dhe është vërtetuar vendimi i ankimuar i Autoritetit të Likuidimit si i drejtë dhe i bazuar në ligj.

Me datë 10 maj 2023, paditësi e dorëzoi në DHPGJS një ankesë të afatshme kundër Aktgjyimit të Shkallës së I-rë të DHPGJS-së, C-IV-13-1022 të datës 24 prill 2023, për të gjitha bazat ankimore dhe kërkon nga Kolegji i Apelit të ndryshohet Aktgjykimi i ankimuar, të aprovet ankesa e paditësit ndaj vendimit të Autoritetit të Likuidimit, të ndryshohet vendimi i ankimuar i Autoritetit të Likuidimit dhe atij ti njihet e drejta për paga për periudhën e cekur në ankesë. Për më tepër në ankesë paditësi ka pohuar se me Aktgjykimin e ankimuar është shkelur neni 282.2 nënpika n) të LPK-së, pasi që nuk janë sqaruar faktet vendimtare mbi të cilat është dhënë vendimi, ndërsa po ashtu nuk ka as arsyetim të mirëfilltë për refuzimin e ankesës. Tutje paditësi pohon se nuk është vërtetuar as gjendja faktike pasi që paditësit i

është ndërprerë marrëdhënia e punës me 22 maj 2007 në bazë të njoftimit të marrëdhënies së punës dhe ky fakt nuk është fare kontestues. Tutje paditësi pohon se për periudhën janar 2006 e deri në prill 2007 ai ka punuar në NSH dhe nuk është paguar, ndërsa paditësi ka qenë i përfshirë në listën e pagave prandaj e paditura duhet të obligohet nga Gjykata ta përmbush detyrimin e vet financiar ndaj paditësit. Këto fakte vërtetohen me Librezën e punës, historinë e llogarisë bankare dhe listën e pagave. Tutje në ankesë ai pohon se Gjykata e Shkallës së I-rë ka mundësi që fare nuk e ka shikuar vendimin e Autoritetit të Likuidimit përndryshe si është e mundur që kur flet për këtë vendim konstaton përmbajtje të cilat vendimi i Autoritetit të Likuidimit nuk e ka. Tutje paditësi pohon se AKP-ja i referohet historisë së llogarisë së klientit në bankë por banka nuk është institucion që i ruan dhe i mban listat e pagave të punëtorëve, ndërsa llogaritë bankare dhe historiku i tyre dëshmojnë vetëm evidencën e pagesave të kryera e jo evidencën e pagesave të pa kryera. Tutje paditësi pohon se listat e pagave janë përpiluar, protokolluar, nënshkruar dhe vulosur nga menaxhmenti i NSH-së, të cilat si dëshmi do të bashkëngjiten me këtë ankesë. Tutje në ankesë paditësi i është referuar edhe disa rasteve të mbyllura në jurisprudencën e Kolegjit të Apelit. Bashkë me këtë ankesë paditësi ka sjellë kopjen e Librezës së punës e mbyllur me 13 prill 2007, një historik të pagesave të llogarisë bankare, kopjen e listës së pagave të pa paguara, një kopje të aktit përcjellës të nënshkruar nga drejtori i ndërmarrjes me të cilën janë dorëzuar regjistri i punëtorëve të NSH-së dhe njësive të saj, Zyrës Rajonale të AKM-së në Prishtinë, një deklaratë nën betim të drejtorit të NSH-së Sh P, kopja e letërnjoftimit të tij, një deklaratë nën betim e llogaritarit të NSH-së A K dhe kopja e letërnjoftimit të tij, kopja e kontratës së punës për drejtorin e NSH-së, një referencë të drejtorit të NSH-së, një Aktvendim të marrëdhënies së punës për drejtorin e NSH-së të datës 21.06.2007 dhe regjistrin e punëtorëve të NSH-së.

Me datë 03 korrik 2023, AKP-ja e dorëzon në DHPGJS një parashtresë dhe i përgjigjet ankesës së paditëses. Në këtë parashtresë AKP-ja e kundërshton ankesën e paditëses si të pabazuar dhe kërkon që të vërtetohet Aktgjykimi i ankimuar i Shkallës së I-rë të DHPGJS-së si i bazuar në ligj. Tutje AKP-ja ka pohuar se në mbrojtjen në padi ka sqaruar mjaftueshëm lidhur me argumentet e ngritura të ankesës dhe përsëritja e atyre argumenteve do të ishte e pa dobishme për mbarëvajtjen e procedurës. AKP-ja ka kërkuar që të refuzohet ankesa si e pabazuar dhe të vërtetohet Aktgjykimi i ankimuar si i drejtë dhe i bazuar në ligj.

Arsyetimi ligjor

Ankesa e paditësit është e bazuar.

Në bazë të nenit 69.1 të Ligjit nr. 06/L-086 mbi Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (LDHP), Kolegji i Apelit vendosi të mos mbajë pjesën gojore të procedurës.

Merita e ankesës dhe vlerësimi i Kolegjit të Apelit

Aktgjykimi i ankimuar i Shkallës së I-rë të DHPGJS-së, nuk është i saktë në rezultat dhe në arsyetimin ligjor, andaj ai duhet të ndryshohet.

Kolegji i Apelit vëren se paditësi me datë 28 qershor 2007, e ka dorëzuar tek Autoriteti i Likuidimit të NSH "Magjistratja" (në likuidim), një kërkesë për kompensim të 16 pagave të pagave të pa paguara duke mos specifikuar periudhën në shumë prej 5,406.08 euro, e cila kërkesë ishte refuzuar si e pa vlefshme me arsyetimin se paditësi nuk ka ofruar shërbime pune për NSH-në, dhe po ashtu nuk ka qenë as në listën e pagave të NSH-së, për periudhën janar 2006 – prill 2007, andaj bazuar në nenin 36.2.2 të Shtojcës së Ligjit të AKP-së, kërkesa e pa mbështetur me prova, është refuzuar si e pavlefshme.

Paditësi në ankesën në Shkallën e I-rë ka kërkuar kompensimin e pagave të papaguara për periudhën janar 2006 – prill 2007, në shumë prej 5,406.08 euro, duke pohuar se Autoriteti i Likuidimit pa ndonjë bazë ligjore e ka refuzuar kërkesën si të pa pranueshme.

Shkalla e I-rë e DHPGJS-së me Aktgjykimin e ankimuar e ka refuzuar ankesën dhe e ka vërtetuar vendimin e ankimuar të Autoritetit të Likuidimit si të drejtë dhe të bazuar në ligj, duke nxjerrë konstatim se paditësi nuk ka ofruar prova materiale për ta mbështetur ankesën, gjegjësisht nuk ka ofruar prova se kur ka themeluar marrëdhënie pune, dhe deri kur ka punuar në NSH.

Kolegji i Apelit vëren se paditësi me ankesën në Shkallën e I-rë nuk e ka sjellur njoftimin për ndërprerje të marrëdhënies së punës me datë 22 maj 2007, të cilët ai

i referohet në ankesë, dhe as nuk e ka sjellur kopjen e Librezës së punës por kishte sjellë një regjistër të pagave të mbetura borxh për periudhën e cekur.

Tutje Kolegji i Apelit vëren se paditësi me ankesën e tij në Shkallën e II-të ka sjellur provat vijuese: kopjen e Librezës së punës e mbyllur me 13 prill 2007, një historik të pagesave të llogarisë bankare, kopjen e listës së pagave të pa paguara, një kopje të aktit përcjellës të nënshkruar nga drejtori i ndërmarrjes me të cilën janë dorëzuar regjistrin e punëtorëve të NSH-së dhe njësive të saj, Zyrës Rajonale të AKM-së në Prishtinë, një deklaratë nën betim të drejtorit të NSH-së Sh P, kopja e letërnjoftimit të tij, një deklaratë nën betim e llogaritarit të NSH-së A K dhe kopja e letërnjoftimit të tij, kopja e kontratës së punës për drejtorin e NSH-së, një referencë të drejtorit të NSH-së, një Aktvendim të marrëdhënies së punës për drejtorin e NSH-së të datës 21.06.2007 dhe regjistrin e punëtorëve të NSH-së.

Nga kopja e Librezës së punës vërehet se paditësit i është ndërprerë marrëdhënia e punës me datë 13 prill 2007, do të thotë në ditën kur është privatizuar NSH "Magjistranja". Paditësi ka sjellur edhe listën e pagave të pa paguara nga NSH-ja e nënshkruar nga menaxhmenti i NSH-së.

Duke u bazuar në këto prova të cilat janë sjellur në Shkallën e II-të, e të cilat në interes të drejtësisë, bazuar në nenin 70 të LDHP-së pranohen nga Kolegji i Apelit, paditësit i njihet e drejta në kompensimin e pagave të pa paguara për periudhën janar 2006 – prill 2007, në shumë prej 5.406.08 euro, pasi që këtë prova vërtetojnë se ai ka kryer shërbime punë për NSH-në, por që nuk është paguar nga ana e NSH-së për punën e kryer.

Kolegji i Apelit vëren se AKP-ja me mbrojtje në ankesë pretendon se në bazë historikut të llogarisë së paditësit të siguruar nga Banka Ekonomike, del që paditësi nuk ka qenë në listën e pagesave dhe se paditësi nuk ka ofruar shërbime pune për NSH-në. Këto pretendime lidhur me këto fakte të pohuara nga AKP-ja, nuk janë mbështetur me prova konkrete, prandaj për këtë arsye nuk janë marrë në konsideratë nga ana e Kolegjit të Apelit.

Në bazë të arsyeve të cekura paditësit i njihet e drejta e kompensimit të pagave të pa paguara për periudhën e cekur në shumë prej 5,406.08 euro, si dhe e drejta

e kompensimit të shpenzimeve të përfaqësimit nga ana e avokatit në shumë prej 208 euro, të cilat shuma do të paguhen sipas prioriteteve të përcaktuara me ligj në procedurën e likuidimit.

Prandaj nga këto arsye, ankesa e paditësit aprovohet si e bazuar, ndryshohet Aktgjykimi i ankimuar i Shkallës së I-rë, dhe aprovohet padia për paga si e bazuar.

Andaj, në bazë të nenit 9.10 të LDHP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

Taksa gjyqësore

Ankuesi tashmë e ka paguar taksën gjyqësore për procedurën ankimore në shumë prej 30 euro me datë 07 qershor 2023, andaj nuk do të caktohen taksa shtesë.

Lëshuar nga Kolegji i Apelit i DHPGJS-së më 12 prill 2024.

Mr.sc. Sahit Sylejmani, Gjyqtar Kryesues
